



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:150255  
Datë: 11.12.2024  
Numri i dokumentit: 06582587

ARJ.nr.115/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar, Milena Djerić dhe Muhamet Rexha, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit B.B., nga fshati H., Rr. “P.B.D” p.n, P., kundër të paditurit Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i aktit - vendimit administrativ të organit të paditur, Ref: RZVGJ/692 të datës 09.11.2018, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.723/2023 të datës 13.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10 Dhjetor 2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi B.B., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.723/2023 të datës 13.06.2024.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.723/2023 të datës 13.06.2024, është vendosur si në vijim: **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit B.B., e datës 23.08.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2942/18, të datës 28.06.2023, **VËRTETOHET**.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit paditësi, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe shkeljes së drejtës materiale, me propozim që të: **APROVOHET** e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të **PRISHEN** Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr.723/2023 të datës 13.06.2024 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2942/18, të datës 28.06.2023, dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosije.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjyqimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të akteve tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga aktet e lëndës rezulton se me vendimin kontestues të të paditurit Ref: ZVVGJ/692 të datës 09.11.2018, REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kandidatit për gjyqtar B.B., e parashtuar kundër vlerësimit dhe rezultateve të Komisionit Rekrutues për Komisionin për Rishqyrtim të KGJK-së.

Kundër vendimit të lartë cekur të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, A.nr.2942/18, të datës 28.06.2023, në dispozitiv ka vendosur si në vijim: I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit B. B., nga fshati H., Rr. "P. B. D" p.n, P., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi RZVGJ/692 të datës 09.11.2018 i të paditurit. II. Mbetet në fuqi vendimi i RZVGJ/692 të datës 09.11.2018 i të paditurit. III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Nga provat formularët e vlerësimit të kandidatëve të datës 04.10.2018, vlerësimi të intervistës me gojë dhe vlerësimit të testit me shkrim të datës 01.07.2018, Listës së kandidatëve për gjyqtarë sipas pikëve të fituara në provimin me shkrim dhe intervistës me gojë të datës 30.10.2018, gjykata vërtetoi se të gjithë anëtarët e Komisionit për Rekrutimin e Gjyqtarëve kanë dhënë vlerësimin e tyre në mënyrë individuale të dhëna me pikë për kandidatin, në këtë rast paditësin. Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të të paditurës si më lartë e të kontestuara nga paditësi, i'u referua Rregullores nr.05/2016 "*neni 4, par.1. Detyrën e noterit mund ta ushtrojë personi që i plotëson kushtet si vijon: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësinë e veprimit; 1.3. të gëzojë integritet personal dhe profesional; 1.4. të ketë diplomuar në njërin nga fakultetet juridike sipas nenit 24 "Rezultatet përfundimtare të provimit 1. Rezultatet përfundimtare mbi suksesin e një kandidati llogariten mbi bazën e pikëve të arritura në testin me shkrim dhe intervistën me gojë. 2. Pas përfundimit të vlerësimit të provimit me gojë, bëhet numërimi dhe verifikimi i rezultateve dhe përgatitja e listës përfundimtare me qëllim të shpalljes së rezultateve të provimit. 3. Një kandidat konsiderohet se ka kaluar me sukses provimin për gjyqtarë nëse arrin të marrë së paku 100 pikë nga të cilat 70 pikë në testin me shkrim dhe 30 pikë në intervistën me gojë. 4. Rezultatet përfundimtare të kandidatëve që e kanë kaluar me sukses provimin publikohet në ueb faqen e KGJK-së dhe njoftimi për këtë përmban emrin, mbiemrin dhe numrin e pikëve të arritura nga kandidati në testin me shkrim dhe intervistën me gojë. 5. Komisioni për Rekrutim e përpilon listën e kandidateve sipas pikëve të fituara në provim. Renditja e kandidatëve bëhet sipas numrit të pikëve të fituara në testin me shkrim dhe intervistën me gojë. Renditja në listë përfundon te numri i kandidatëve të përcaktuar me shpallje nga KGJK. Në rast se kandidatët e fundit në listë kanë pikë të njëjta, konsiderohen se ata e kanë kaluar provimin. 6.*

*Kryetari i Komisionit për Rekrutim e dërgon listën e kandidatëve të suksesshëm në KGJK pas shqyrtimit të ankesave eventuale nga Komisioni për rishqyrtim”. Me nenin 20 të Ligjit nr.06/L-055, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës “(Rekrutimi i Gjyqtarëve) 3. Këshilli zhvillon procedurat për rekrutimin e kandidatëve për t’u emëruar si gjyqtarë të cilat janë në përputhje me Kushtetutën dhe kriteret e përcaktuara me ligj. 4. Procedura për vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatit për t’u bërë pjesë e gjyqësorit do të bëhet përmes vërtetimit të të dhënave të dorëzuara nga kandidati, të dhënat nga regjistrat publik relevantë për vlerësim, përfshirë verifikimin standard të regjistrave për të kaluarën kriminale. 5. Procesi i rekrutimit të gjyqtarëve porotë do të përcaktohet me rregullore të Këshillit dhe kryhet nga gjykatat përkatëse”.*

Tutje thekson se, përveç referimeve ligjore, gjykata mori për bazë dhe vlerësoi edhe provat e administruara dhe duke u bazuar në formularët e vlerësimit të kandidatëve të datës 04.10.2018, vlerësimi të intervistës me gojë dhe vlerësimit të testit me shkrim të datës 01.07.2018, gjykata ka vërtetuar se paditësi nuk ka arritur pikët e mjaftueshme konform Rregullores nr.05/2016 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve, nenin 24. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e paditësit sipas të cilit paditësi ka parashtruar dokumente të mjaftueshme dhe konsideron se ka përmbushur të gjitha kushtet e kërkuara, duke theksuar se “marr parasysh provat e dorëzuara nga e paditura, rezulton se vlerësimi për kandidatin-paditësin ka qenë i manipuluar dhe i kurdisur. Këtë konstatim e forcon edhe më tej fakti se e paditura ka dështuar të siguroj provën kryesore video-incizimin i cili do të vinte në pah manipulimet e komisionit (...), gjykata të njëjtat pretendime i refuzoi si të pabazuar ngase se provat e kërkuara nga paditësi gjykata përpos video-incizimit të tjerat i ka vlerësuar me kujdes dhe ka konstatuar se gjatë procesit të vlerësimit të kandidatit-paditësit nuk ka gjetur pa rregullsi gjatë vlerësimit të paditësit.

Ndërsa sa i përket provës së video-incizimit, gjykata ka vlerësuar se mos prezantimi i kësaj prove dhe vlerësimit të saj nuk ka ndikim në vendosjen në këtë çështje duke u nisur nga fakti se provat të cilat i ka vlerësuar gjykata kanë qenë të mjaftueshme sepse anëtarët e komisionit gjatë intervistës me gojë të paditësit kanë qenë prezentë dhe kanë vlerësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë paditësin dhe vlerësimin e tyre secili në mënyrë individuale e kanë dhënë me pikë në formularët e vlerësimit të kandidatit. Andaj, në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, e ka refuzuar si të pabazuar padinë e paditësit dhe në bazë të nenit 5, 6, 38, 43, 46.2, dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së dhe 200 të Ligji për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit. Tutje vlerëson se, dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është në pajtueshmëri të plotë me arsyetimin dhe se në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i Apelit.

Në arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë tutje të tjera theksohet se: Në raport me pretendimin e palës ankuese se gjykata e shkallë së parë nuk ka bërë vlerësimin real për të gjitha provat dhe fakteve të ofruara nga ana e paditësit, edhe këto pretendime kolegji i Gjykatës së Apelit i refuzon si të pa bazuara për faktin se e njëjta ka bërë administrimin e provave dhe fakteve të ofruara nga paditësi dhe e paditura, si dhe ka bërë elaborimin e tyre në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 160 të LPK-së. Në raport me pretendimin e paditësit se të njëjtit i është mohuar qasja për të parë video-incizimin lidhur me intervistën, Kolegji vlerëson se në rastin konkret, gjykata nuk ka mundësi të ndikojë në vlerësimin e bërë nga anëtarët e komisionit, sepse të njëjtit i kanë të gjitha kompetencat e vlerësimit të kandidatit, sipas rregullave të cilat i përcaktojnë për të gjithë kandidatët. Poentimi gjatë intervistës, bëhet përveç tjerave edhe sipas vlerësimit të integritetit personal dhe profesional dhe se detyra e anëtarëve të komisionit është të bëhet vlerësimi në bazë të cilësive të kandidatit, duke parë karakteristikat e tij, të kaluarën e tij, sjelljen e tij gjatë intervistës, etj., prandaj gjykata nuk ka tagër të ndërhy në ndryshimin e poentimit sa i përket kësaj pjese, ndërsa sa i përket pjesës tjetër të vlerësimit, duke u bazuar në shkresat e lëndës gjykata vlerëson se e paditura drejtë dhe saktë ka vlerësuar paditësin mbi bazën e meritave, prandaj vendimi i të paditurës është i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimit të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës vlerëson se, gjykata e shkallës së dytë ka vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës të paditësit, dhe vërtetimin e aktgjykimit të shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pabazuar të kërkesë padisë së paditësit.

Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, ka rezultuar se vendimi i të paditurit KGJK, si në aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë me të drejtë ka rezultuar se është vendim i drejtë dhe ligjor. Edhe sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, i padituri KGJK ka vepruar drejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 24 dhe 25 të Rregullores nr.05/2016 për Rekrutimin, Provimin dhe Rimërimin e Gjyqtarëve, me refuzimin e ankesës së ankuesit paraqitur kundër vlerësimit dhe rezultatit të përfundimtar të arritur dhe të vlerësuar sipas komisionit për regrutim të KGJK-së.

Gjykata shqyrtoi pretendimet e paditësit të theksuara si në kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, mirëpo të njëjtat i refuzon si të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, komisioni i KGJK-së drejtë ka zhvilluar procedurën e rekrutimit dhe ka poentuar në mënyrë diskrecionale kandidatin, këtu paditësin, për çka gjykata në bazë të legjislacionit në fuqi, Ligjit për KGJK dhe Rregulloren për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Rimërimin e Gjyqtarëve nuk ka tagër dhe kompetencë të ndërhyjë apo ndryshojë vlerësimin-poentimin e kandidatit, dhe rezultatit e arritur në procedurë të regrutimit nga ajo e bërë nga komisioni, ku në poentim dhe rezultat përfshihen edhe integriteti personal

dhe profesional. Për deri sa video-incizimi në këtë çështje nuk do të paraqite provë mbi bazën e së cilës do të mund të vlerësoheshin apo ndryshoheshin faktet vendimtare lidhur me poentimin e paditësit dhe ndryshimin e rezultatit përfundimtar në favor të tij.

Gjykata Supreme ka vërejtur se gjykata e shkallës së parë gabimisht i referohet Rregullores nr.05/2016 për Rekrutimin, Provimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve, kur konstaton se: në bazë të “nenit 4, par.1. Detyrën e noterit mund ta ushtrojë personi që i plotëson kushtet si vijon: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësinë e veprimit; 1.3. të gëzojë integritet personal dhe profesional; 1.4. të ketë diplomuar në njërin nga fakultetet juridike”, megjithatë të njëjtin e konsideron si gabim të natyrës teknike dhe pa ndikim në vendosjen ndryshe.

Aktgjykimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë, nuk rezulton se është i përfshirë as me shkelje procedurale të dispozitave nga neni 182 par. 2, pika (n) të LPK-së, siç pretendon paditësi në kërkesën e tij. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate i njëjti është i qartë dhe i kuptueshëm dhe në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, gjykata vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e tjera si në kërkesë por vlerësoj se të njëjtat janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për vendosjen ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur gjykatat e instancave më të ulëta. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes në mënyrë meritore, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë.

Nga theksimet si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1, të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË  
ARJ.nr.115/2024, më datë 10 Dhjetor 2024

B. Profesionale,  
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,  
Ragip Namani